

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Te "Rana e Hedhun" në Shëngjin janë sulur biznesmenë, mafiozë, politikanë, shtetarë, mediatikë,....                                                                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://kohajone.com/kryesore/te-rana-e-hedhun-ne-shengjin-jane-sulur-biznesmene-mafioze-politikane-shtetare-mediatike/">https://kohajone.com/kryesore/te-rana-e-hedhun-ne-shengjin-jane-sulur-biznesmene-mafioze-politikane-shtetare-mediatike/</a> |
| BURIMI  | kohajone.com                                                                                                                                                                                                                                                  |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 10 shtator 2026, 16:02:02 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 15:55:48 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 1ed885ce366fa66c8059be9cbeb87eae12c20edf2797c6ed872e0c56cc8c4fce |
| TEKSTI     | 2f7dd733703439c14b046336c4d47a4368c78875940c18c880dfed464c7ef99f |
| PAMJA      | 5e924d7f7ebca9549d169f9b9370aea694da16b1701cf050a6fd71f0d168fe92 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 38a229e434389d361661cd33521fcb7cd7864b98bd55b4b69b1fb9b9e54947e8                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | dace51e7441cb8a7a30c18c1465fab1a5b574f72117cfb6abc94c5dbbad3d867                                                                                                   |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/38a229e434389d361661cd33521fcb7cd7864b98bd55b4b69b1fb9b9e54947e8>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

## Te “Rana e Hedhun” në Shëngjin janë sulur biznesmenë, mafiozë, politikanë, shtetarë, mediatikë,....

[Kryesore](#) E Enjte, 10 Shtator 2026 17:55



“Rana e Hedhun” në Shëngjin është një nga perlat më të rralla turistike dhe natyrore të Shqipërisë. Një monument i krijuar nga natyra, të cilin shumë vende do ta ruanin si pasuri kombëtare. Por në Shqipëri, çdo copë bregdeti që mbetet ende e paprekur rrezikon të kthehet në plaçkë për të fortët, oligarkët dhe sekserët e pushtetit.

Muajt e fundit, rreth “Ranës së Hedhun” është shtuar një oreks i frikshëm për toka, leje ndërtimi dhe leje zhvillimi. Biznesmenë, njerëz me lidhje politike, personazhe të botës së krimit dhe ndërmjetës të çdo lloji po përpiqen të fusin duart në këtë pasuri të jashtëzakonshme. Synimi duket i qartë: të marrin sot tokën dhe nesër të mbulojnë me beton një nga peizazhet më të bukura shqiptare.

 [Koha YouTube Channel](#)

Në këtë luftë për pronat dyshohet se po përdoren para, presione, ryshfete, dokumente të dyshimta dhe vendime gjyqësore. Hipoteka, administrata dhe gjykatat nuk mund të shërbejnë si zyra legalizimi për grabitjen e bregdetit. Ato duhet të mbrojnë pronën dhe ligjin, jo të prodhojnë pronarë të rinj sipas interesave të mafies.

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

Sipas informacioneve ende jozyrtare, SPAK-u ka nisur verifikime për pastrim parash ndaj tre biznesmenëve që dyshohet se po përpiqen të shtrijnë kontrollin e tyre në këtë zonë. Po kështu, ka dyshime se në manovrat për tjetërsimin e pronave mund të jenë përfshirë edhe njerëz të drejtësisë.

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Një nga çështjet që kërkon përgjigje është mënyra se si hidhen shortet për dosjet e pronave në “Ranën e Hedhun”. Si është e mundur që çështjet e kësaj zone, sipas dyshimeve të ngritura, përfundojnë vazhdimisht të një apo dy gjyqtarë të caktuar të Apelit? Është rastësi, manipulim i sistemit apo një skemë e organizuar?

Kjo duhet hetuar deri në fund.

Nëse ka ndërhyrje në shortin gjyqësor, nuk kemi më të bëjmë vetëm me një konflikt pronësie. Kemi të bëjmë me kapjen e drejtësisë dhe vendosjen e saj në shërbim të interesave kriminale. Nëse gjyqtari përcaktohet përpara se të hidhet shorti, atëherë vendimi mund të jetë shkruar përpara se të nisë procesi.

Dyshimet thuhet se shkojnë deri në Gjykatën e Lartë. Pikërisht për këtë arsye, SPAK-u nuk duhet të ndalet te biznesmenët apo sekserët e nivelit të ulët. Duhet të ndjekë paratë, telefonatat, takimet, ndërhyrjet në sistemin elektronik, vendimet e dyshimta dhe çdo lidhje ndërmjet pronarëve të rinj, politikës dhe gjyqësorit.

Askush nuk mund të jetë mbi ligjin. As biznesmeni me miliona euro, as politikani që premtonte leje, as zyrtari që ndryshon dokumentet dhe as gjyqtari që mund të ketë kthyer çekiçin e drejtësisë në çekiç ankandi.

“Rana e Hedhun” nuk është pronë e mafies. Nuk është plaçkë e pushtetit dhe as parcelë për t’u ndarë në tavolina restorantesh mes sekserëve, biznesmenëve dhe njerëzve të drejtësisë. Ajo është pasuri e Shëngjinit, e Lezhës dhe e gjithë Shqipërisë.

SPAK-u ka përpara një provë të rëndësishme: të tregojë nëse shteti është më i fortë se mafia e tokave. Hetimi duhet të shkojë deri në fund, pavarësisht emrave dhe institucioneve që mund të dalin gjatë rrugës. Njëkohësisht, institucionet shtetërore duhet të pezullojnë çdo leje apo procedurë të dyshimtë deri në sqarimin e plotë të pronësisë dhe burimit të parave.

Nëse hesitim sot, nesër do të shohim pallate, resorte dhe mure betoni mbi rrëën që natyra e krijoi gjatë shekujve. Atëherë do të jetë tepër vonë.

“Rana e Hedhun” duhet të mbetet një bukuri e hedhur nga natyra, jo një pasuri e rrëmbyer nga mafia!

Ndërkohë mësohet se SPAK ka filluar një hetim për pastrim parash për tre biznesmenë që po fusin kthetrat aty, sikurse ka informacione, akoma jo zyrtare, se në këto lojëra tjetërsimesh e manovrash janë futur edhe gjyqtarë të Apelit. SPAK po heton se si ka mundësi që kur hidhen shortet për dosjet e tokave në Rana e Hedhun i bie shorti përherë një apo dy gjyqtarëve!

Por për dreq dyshohet edhe nga Gjykata e Lartë, por gjithsesi pritet nga SPAK se deri ku do të arrijnë në hetime.



## SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)

 Logo KOHA JONË SONDZH

**A duhet liruar Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?**

☐ Po


☐ Jo

[Më shumë nga Kryesore](#)







[Gjyqtarët ultimatum institucioneve: Pagat duhet të zhblokojen, vendi...](#)



[Bashkia e Tiranës pa kryetar, Rama: "Prerja e kokës së kryeqyte...](#)



[Qeveria dhe gjyqësori në luftë për pagat, një përplasje e padëgjuar n...](#)



[Erdhi SPAK-u! Ikni burra!](#)




[Kreu i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi: Pavarësia e gjyqësorit nuk n...](#)



[Komiteti Shqiptar i Helsinkit, letër “313”-ës: Jepini fun...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)



[Ambasadori gjerman, Karl Bergner: Reforma në Drejtësi faktor kyç në avancimin e Shqipërisë drejt BE-së](#)

16 minuta më parë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.